



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti Ligjor/Pravni Departament/ Legal Department

Për:	Ardian Gjini, Kryetari i Komunës së Gjakovës Arbneshia Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës	
Kopje:	Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme, MAPL Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Kujtim Aliu, Zyrtar i lartë për Monitorim të Komunave	
Përmes:	Faton Peci, Ministër i MBPZHR-së	
Nga:	Isah Rudaku, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, MBPZHR	Datë: 15.08.2022 Ref. 10.269/2022
Zyrtarët përgjegjës: 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Isah Rudaku, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, MBPZHR	
Lënda:	Përgjigje në Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Gjakovës	
Lloji i aktit:	Rregullore Nr.01-19340 për Taksa Komunale	

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, më datë 03.08.2022 e ka pranuar nga MAPL aktin e miratuar nga kuvendi i komunës së Gjakovës Rregulloren Nr.01-19340 për Taksa Komunale, të miratuar me datën 28.07.2022 si dhe i parashtruar për shqyrtim në MAPL, me datën 01.08.2022.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës.

Konfirmim për Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit

Rregullorja Nr.01-19340 për Taksa Komunale, neni 23, duhet të plotësohet si vijon:

1. Shërbimet profesionale për prerje të pyjeve private:

- 1.1. Dru Zjarri për m³, në shumën prej 1.50€
- 1.2. Dru Zjarri mbi 7m³ në shumën prej 2.00€
- 1.3. Dru Teknik për m³ në shumën prej 3.00€

2. Lartësia e taksës për shfrytëzimin e kullosave

Lloji i bagëtisë	NB / kokë	EUR / kokë
Gjedhët mbi një vjet	1	1.20
Viçat	0.45	0,54
Delet	0.18	0.22
Qengjat	0.1	0,12
Kuajtë dhe gomarët	1	1.20
Dosat	0.5	0.60
Derrat	0,3	0.36
Rosat	0.014	0,02

Arsyetim

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, taksat për shërbimet profesionale për prerje të pyjeve private i ka të përcaktua në nenin 6 të Udhëzimit Administrativ MA-NR.12/2005 për caktimin e çmimeve – taksave për shfrytëzimin e produkteve pyjore-drunore, jo drunore dhe shërbime profesionale teknike, të datës 16 maj 2005.

Për lartësinë e taksave për shfrytëzimin e kullosave, Ministria përkatëse për bujqësi i ka të përcaktuara në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ MA-NR.09/2007 për shfrytëzimin e kullotave të datës 30.03.2007.

Ministria përgjegjëse për bujqësi, kërkon që taksat për shërbimet profesionale për prerje të pyjeve private dhe lartësia e taksës për shfrytëzimin e kullosave të harmonizohen me legjislacionin përkatës në fuqi.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Gjakovës, që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mbetet në dispozicion të komunës dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt,

Burim Bajrami

From: Kujtim Aliu
Sent: Tuesday, August 9, 2022 9:56 AM
To: Burim Bajrami
Subject: FW: Vlersimi i ligjshmerise së Rregullores Nr. 01-19340 për taksa, tarifa komunale të miratuar nga Kuvendi Komunal në Gjakovë
Attachments: 43-679-1-2022.pdf; 43-679-2022.pdf

From: Florije.H.Rexhepi
Sent: Monday, August 8, 2022 2:48 PM
To: Xhevat Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>; Kujtim Aliu <kujtim.aliu@rks-gov.net>
Cc: Naim Bardiqi <Naim.Bardiqi@rks-gov.net>; Rifat Latifi <Rifat.Latifi@rks-gov.net>; Venera Çerkini <Venera.Cerkini@rks-gov.net>; Aferdita Syle Hoxha <aferdita.syle.hoxha@rks-gov.net>
Subject: Vlersimi i ligjshmerise së Rregullores Nr. 01-19340 për taksa, tarifa komunale të miratuar nga Kuvendi Komunal në Gjakovë

Të nderuar,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Shëndetësisë ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmerisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal, Rregulloren Nr. 01-19340 për taksa, tarifa komunale të miratuar nga Kuvendi Komunal në Gjakovë.

Ministria e Shëndetësisë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës Rregulloren Nr. 01-19340 për taksa, tarifa komunale për vitin 2022, konstaton se në rregulloren e cekur më lartë nuk është e përfshirë Drejtoria për Shëndetësi dhe mirëqenie sociale, (Tabela e bashkë-pagesave për shërbimet shëndetësore në nivel parësor i përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr.04/2007 Mbledhja dhe shfrytëzimi i mjeteve nga bashkë-pagesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrave vetanake të Institucioneve Shëndetësore,) si dhe „ Çmimorja për certifikatat shëndetësore” sipas Udhëzimit Administrativ për Certifikatat Shëndetësore Nr.04/2013.

Ministria e Shëndetësisë, mbetet në dispozicion të MAPL dhe Komunës së Gjakovës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt,

Florije Rexhepi, Ma. sc
Zyrtare e Lartë Ligjore;
Departamenti Ligjor, MSh.
Tel. zyre: +381 (0) 38 200 24 509